

THIRRJE PËR DËRGIMIN E DORËSHKRIMEVE

AKTET, Revista Shkencore e Institutit Alb-Shkenca pranon dërgimin e dorëshkrimeve të punimeve të prezantuara gjatë Takimit X Ndërkombëtar në Shkup. Dorëshkrimet duhet të dërgohen nëpërmjet sistemit elektronik ALPA, në adresën, <http://alpa.mali-it.eu/journal/aktet/>. Sistemi ALPA aktivizohet për pranimin e dorëshkrimeve në datën **27.03.2017**. Afati i fundit për dërgimin e dorëshkrimeve është **30.04.2017**.

UDHËZUES PËR AUTORËT

AKTET boton punime të prezantuara gjatë Takimit Vjetor të Instituti Alb-Shkenca (IASH). Kjo revistë boton vetëm punime origjinale që sjellin njohuri të reja dhe të rëndësishme për avancimin e shkencës. Revista drejtohet prej Këshillit Botues, i cili përbëhet prej një kryeredaktori, një redaktori teknik dhe disa redaktorëve shkencorë përgjegjës për fusha të veçanta të shkencës. Autorët që kanë prezantuar gjatë takimit vjetor të IASH mund t'i dërgojnë punimet e tyre për botim.

Dorëshkrimet duhet të paraqiten në gjuhën angleze. Dorëshkrimet në shqip nuk do të pranohen, me përjashtim të punimeve në fushën e Albanologjisë të cilat mund të dërgohen në shqip ose anglisht. Dërgimi i dorëshkrimit nënkupton që punimi i paraqitur në të nuk është botuar më parë (përveçse në formën e një përmbledhjeje, leksioni apo tezave akademike), nuk është në shqyrtim për t'u botuar gjetkë dhe se botimi është aprovuar nga të gjithë autorët, si dhe autoritetet përgjegjëse ku hulumtimi është kryer. Autorëve do t'u kërkohet që të paraqesin, nëse ka ndonjë konflikt interesash, si dhe ndonjë burim financiar të veçantë të përdorur për kryerjen e kërkimit. Nëse dorëshkrimi pranohet për botim ai nuk mund të botohet në të njëjtën formë diku tjetër pa marrë më parë leje me shkrim nga IASH.

Plagjiatura nuk lejohet dhe do t'u raportohet si autorit, ashtu edhe autoriteteve përkatëse. Konkluzionet duhet të justifikohen nga skema eksperimentale dhe të dhënat e paraqitura. Informacioni duhet të jetë i detajuar në mënyre që të lejojë përsëritjen e punës nga shkencëtarë të tjerë të së njëjtës fushë. Autorët duhet t'i ruajnë të dhënat eksperimentale dhe t'ia paraqesin Këshillit Botues, nëse u kërkohen. Shkrimi duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm, konciz dhe korrekt nga ana gramatikore. Autorët mbajnë përgjegjësi për anën shkencore dhe formale të materialeve që paraqesin, si dhe për çdo korrespondencë me redaktorët.

ORGANIZIMI I DORËSHKRIMIT

Dorëshkrimi nuk duhet të ketë më shumë se 2500 fjalë ose gjithsej 5 faqe, duke përfshirë këtu titullin, përmbledhjen, tekstin, bibliografinë, tabelat, grafikët, etj. Dorëshkrimi duhet të shkruhet në Microsoft® Office Word (versioni i 2003 – it ose ndonjë version i mëvonshëm), faqja dihet të jete 176 mm x 250 mm (6.93 inch x 9.85 inch), me një hapësirë prej 22.86 mm (0.9 inch) në maje dhe në fund dhe 12.7 mm (0.5 inch) në të dyja anët, fonti duhet të jetë Calibri. Dorëshkrimi nuk duhet të ketë footnotes, endnotes; faqet duhet të numërohen. Një model me detajet e formatimit të kërkuar jepet në fund të këtij udhëzuesi.

Dorëshkrimi duhet të përmbajë elementet e paraqitura më poshtë.

1. **Titullin:** Duhet të jetë sa më konçiz dhe i qartë. Emrat e autorëve duhet t'i kenë adresat e plota dhe autori korrespondues ta ketë adresën e email – it. Mbishkrimet a, b, c mund të përdoren për ta përkatësuar autorin me institucionin.

2. **Fjalët çelës:** Duhet të paraqiten 4-5 fjalë të zgjedhura me kujdes që të pasqyrojnë subjektin e punimit.

3. **Përmbledhjen:** Duhet të paraqesë thelbin e punimit dhe konkluzionet; nuk duhet të jetë më e gjatë se 150 fjalë. Përmbledhja duhet të paraqitet në dy gjuhë, anglisht dhe shqip.

4. **Hyrien:** Duhet të përshkruajë shkurt bazën për punën e paraqitur, si dhe punën shkencore të mëparshme të referuar në mënyrë të përshtatshme. Duhet gjithashtu të tregohen objektivat, arsyet e ndërmarrjes së studimit si dhe rëndësia e tij.

5. **Materialet dhe Metodat:** Duhet të paraqiten në mënyrë të detajuar materialet dhe procedurat eksperimentale. Informacioni duhet të jetë i mjaftueshëm që të lejojë përsëritjen e punës prej të tjerëve.

6. **Rezultatet dhe Diskutimet:** Rezultatet duhet të jenë të qarta dhe të ilustruara në tabela dhe grafikë. Rezultatet eksperimentale duhet të analizohen statistikisht dhe bazuar në to të nxirren përfundime në bazë të një besueshmërie statistikore. Implikimet që vijnë nga rezultatet e paraqitura duhet të diskutohen në mënyrë të plotë. Përfundimet duhet të lidhen direkt me rezultatet e marra. Ato nuk duhet të jenë spekulative dhe të përgjithësuara prej literaturës apo njohurive të përgjithshme e spontane.

7. **Bibliografia:** Burimet e literaturës duhet të listohen numerikisht në mënyrë alfabetike në bazë të mbiemrit të autorit të parë. Çdo burim literature duhet të referohet në tekst me numrin përkatës. Punimi nuk duhet të ketë më shumë se 20 burime literature. Nëse një burim do të citohet 'në shtyp' (in press) do të thotë se ky punim është pranuar për botim. Dorëshkrimet e papranuara për botim nuk mund të citohen. Gjithashtu nuk pranohen referenca nga interneti me përjashtim të botimeve që bëhen online.

8. **Tabelat:** Tabelat duhet të kenë numra dhe tituj. Në tërësi në punim nuk lejohet të ketë më shumë se 5 tabela.

9. **Figura ose Grafikë:** Dorëshkrimi mund të përmbajë figura ose/dhe grafikë. Figurat nuk duhet të jenë përshkrimore. Figurat dhe grafikët duhet të kenë numra e tituj dhe në tërësi nuk duhet të jenë më shumë se 5 të tilla.

Dorëshkrimet nga fushat e shkencave shoqërore mund të mos përmbajnë elementet 5 dhe 6 në mënyrën e paraqitur me sipër. Dorëshkrimet të cilat nuk i përgjigjen formatimit të mësipërm nuk do të merren në konsideratë.

Dorëshkrimet që nuk i përmbahen këtyre kërkesave (1 – 9), nuk merren parasysh dhe i kthehen autorëve.

MODEL PER FORMATIMIN E DORESHKRIMIT

TITLE (anglisht, germa kapitale, bold, Calibri, 12 pt.)

TITULLI (shqip, germa kapitale, bold, Calibri, 12 pt.)

EMRAT E AUTOREVE (germa kapitale, bold, Calibri, 10 pt.)

Adresat, email (germa normale, Calibri, 10 pt.)

PERMBLEDHJE

(shqip, teks normal, Calibri, 9 pt., paraqitur ne nje paragraf, nuk duhet te jkete kryeradhe, jo me shume se 150 fjale)

Fjalët çelës: (shqip, teks normal, Calibri, 9 pt.)

SUMMARY

(anglisht, teks normal, Calibri, 9 pt., one paragraph, no more than 150 words))

Key words: (anglisht, teks normal, Calibri, 9 pt.)

HYRJE

(Faqja duhet te formatohet ne dy kolona, hapësira ndërmjet kolonave 7.62 mm (0.3 inch), Calibri, 10 pt.,)

MATERIALET DHE METODAT

(Faqja duhet te formatohet ne dy kolona, hapësira ndërmjet kolonave 7.62 mm (0.3 inch), Calibri, 10 pt.,)

REZULTATET DHE DISKUTIMI

(Faqja duhet te formatohet ne dy kolona, hapësira ndërmjet kolonave 7.62 mm (0.3 inch), Calibri, 10 pt.,)

Tabela 1.

(Duhet te perfshihet te tekts ne vendin e duhur, Calibri 10pt)

Figura 1.

(Duhet te perfshihet te tekts ne vendin e duhur, Calibri 10pt)

Formulat dhe ekuacionet matematikore duhet te shkruhen me Microsoft equation ne Calibri 9 pt.

KONKLUZIONE

(Faqja duhet te formatohet ne dy kolona, hapësira ndërmjet kolonave 7.62 mm (0.3 inch), Calibri, 10 pt.,)

BIBLIOGRAFIA

(Faqja duhet te formatohet ne dy kolona, hapësira ndërmjet kolonave 7.62 mm (0.3 inch), Calibri, 10 pt.).

Shembuj të referimit të një artikulli dhe një libri :

1. Libby WF, Anderson EC, Arnold JR (1949), Age determination by radiocarbon content. Science 109, 227-228.
2. Strunk W, White EB (1979), The elements of style, third ed. Macmillian, New York;

PROCEDURA E PRANIMIT

Dorëshkrimet duhet të dërgohen nëpërmjet sistemit elektronik ALPA në adresën, <http://alpa.mali-it.eu/journal/aktet/>. Udhëzimet në lidhje me përdorimin e këtij sistemi do t'i gjeni gjithashtu në adresën e mësipërme si edhe në adresën www.alb-shkenca.org.

Dorëshkrimet duhet të dërgohen brenda afatit të përcaktuar nga Këshilli Botues. Dorëshkrimet duhet t'i bashkëngjitet një mesazh i shkurtër prej autorit drejtuar Këshillit Botues, ku duhet të shprehet dëshira për botimin e punimit, të tregohet pjesëmarrja në takimin vjetor të IASH, si dhe të specifikohet simpoziumi ku është prezantuar punimi. Autorit korrespondues i kërkohet gjithashtu që të paraqesë ndonjë burim financiar që është përdorur për kërkimin shkencor.

Dorëshkrimet do të vlerësohen nga recensentë, identiteti i të cilëve nuk do t'iu zbulohet autorëve. Këshilli Botues do t'i zbatojë rekomandimet e recensentëve në marrjen e vendimit përkatës dhe do t'ia komunikojë këtë vendim autorëve. Autorët mund të marrin përgjigje për vendimin e Këshillit Botues brenda një periudhë 3-4 mujore. Eksperienca e fituar gjatë përgatitjes së vëllimeve të mëparshme të AKTEVE, tregon se ka raste kur procesi i recensimit mund të zgjasë edhe më shumë se kaq. I gjithë ky proces do të dokumentohet në mënyrë elektronike në arkivin e Institutit.

Autori(ët) e çdo dorëshkrimi të pranuar duhet të paguajnë 50 Euro, nëse autori i parë i punimit nuk është anëtar i IASH për vitin kalendarik 2016.